

**WORCESTER
PUBLIC SCHOOLS**

DOHERTY MEMORIAL HIGH SCHOOL

John N. Staley
Chair - Science and Engineering

299 Highland Street
Worcester, MA 01602-2193
508-799-3270
508-799-3276 (Fax)
StaleyJ@worc.k12.ma.us



1 Nëntor, 2015

I Dashur Prind/Kujdestar:

Gjatë përgatitjes tuaj dhe të fëmijës tuaj për të shkuar në shkollën e mesme (high school) në këtë vjeshtë 2016, unë ju inkurajoj ju që të konsideroni Akademinë e Inxhinierisë&Teknologjisë (ETA) në Doherty Memorial High School, si një program rigoroz, përgatitës për një kolegji 4 vjeçar, dhe si një program profesional.

Akademia e Inxhinierisë&Teknologjisë (ETA) u themelua në vitin 2002, dhe morri kartën (charter) profesionale në vitin 2009. Në klasat e 9 dhe 10, nxënësit e ETA bashkohen në grupe, të ngjashme me eksperiencat e nxënësve në shumë shkolla tetëvjeçare. Ky model ka ndihmuar në lehtësimin e sfidave që ndeshin nxënësit gjatë tranzicionit nga shkolla tetëvjeçare në atë të mesme. Për të ndihmuar më tej performancën e nxënësve, mësuesit ETA në Klasën e 9 përdorin strategjitë dhe filozofitë e AVID, të cilat e vënë theksin në aftësitë e mira të nxënësve, siç janë mbajtja e shënimeve efikase, menaxhimi i kohës, strategjitë e studimit, dhe organizimi. Në klasat 11 dhe 12 nxënësit mund të vazhdojnë që të marrin klasa të Inxhinierisë dhe Teknologjisë, edhe pse ata nuk janë të bashkuar në grupe gjatë gjithë subjekteve të tyre akademike. Kjo gjë ju ofron nxënësve akses më të madh në sferën zgjedhëse, Vendosi e Avancuar (AP), dhe në klasat Virtuale të High School që ofrohen në Doherty.

Akademia e Inxhinierisë&Teknologjisë punon nga afër me bizneset lokale, industrinë dhe institutet e arsimit të lartë. Për shembull, partneriteti i ETA me Worcester Polytechnic Institute u njoh në shkallë kombëtare nga American Society for Engineering Education si një shkollë e mesme dhe ekip universitar kryesor (premier). Boston Museum of Science e ka paraqitur ETA si një shembull të bashkimit të fortë ndërmjet shkollave publike dhe instituteve post-sekondare. Ne ofrojmë klasa sfiduese honors dhe klasa të vendosjes së avancuar, lidhje të forta biznesi, dhe marrëveshje artikulumit me institucione post-sekondare dhe të arsimit të lartë 2 dhe 4 vjeçar lokal.

Nxënësit tanë gjithashtu shkëlqejnë në organizatat studentore. Doherty ka 36 skuadra atletike dhe mbi 30 klube dhe aktivitete. Për shkak të këtij rrjeti të madh organizatash, nxënësit janë në gjendje që të krijojnë shoqëri brenda dhe jashtë komunitetit të shkollës.

Ne shpresojmë që ju do të konsideroni Akademinë e Inxhinierisë&Teknologjisë në Doherty Memorial High School për arsimin e mesëm të fëmijës tuaj. Cdo nxënës i interesuar për të hyrë në programet ose shkollat profesionale të qytetit duhet të plotësojë një aplikim. ***Një aplikim për në ETA është i përfshirë me këtë letër, si dhe është gjithashtu i disponueshëm tek këshilltari udhëzues (guidance counselor) i fëmijës tuaj. Aplikimet e plotësuara duhet të kthehen tek këshilltari udhëzues (guidance counselor) i tyre. Do të ofrohet transport për fëmijën tuaj nëse ju aktualisht jetoni jashtë sektorit përfshirës të Doherty.*** Aplikimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme duke filluar nga Janari, dhe vendet janë të kufizuara. Doherty High School do të mbajë një **Open House në 9 Nëntor, nga 6:00 – 8:00 p.m.** Gjatë kësaj kohe, nxënësit dhe familjet e tyre mund të vizitojnë ndërtesën, mund të flasim me mësuesit dhe nxënësit e ETA, anëtarët e stafit nga departamentet e tjera mësimore, si dhe me përfaqësuesit e organizatave studentore. Ju lutem kontaktoni Kryetarin e Technology and Engineering Department- John Staley- në (508)799-3270 ose StaleyJ@worc.k12.ma.us për çdo pyetje që mund të keni.

Sinqerisht,

John N. Staley
Science, Technology & Engineering

Department Chair

SAMPLE